

Origj. Anglisht / vers.Albanian  
Unofficial, unrevised version



SS-AC (98) 6

**MODEL DISPOZITASH  
PER NJE MARREVESHJE DYPALESHE  
TE SIGURIMEVE SHOQERORE  
DHE RAPORT SHPJEGUES**

**KOMITETI I EKSPERTEVE PER ZBATIMINE KONVENTES EVROPIANE  
PER SIGURIMET SHOQERORE (SS-AC)**

**MARREVESHJE NDERMJET**

**X**

**DHE**

**Y**

**MBI SIGURIMET SHOQERORE**

Qeveria e x

dhe

Qeveria e y

Duke deshiuar te rregullojne marredheniet ndermjet te dy Shteteve ne fushen e sigurimeve shoqerore, kane rene dakord si vijon:



## **PJESA I**

### **DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

#### **Neni 1**

##### Perkufizime

-

-

1. Per qellimet e kesaj Marreveshjeje:

(a) x do te thote ..... dhe y do te thote.....;

(b) termi "territor" do te thote.....;

(c) termi "vendas i nje Pale Kontraktuese" do te thote nje person i kombesise se njeres Pale Kontraktuese;

(d) termi "legjislacion" nenkupton te gjitha ligjet, rregulloret dhe instrumenta te tjere ligjore qe jane ne fuqi ne te gjitha apo ne ndonje pjese te territorit te njeres Pale Kontraktuese dhe qe lidhen me deget dhe skemat e sigurimeve shoqerore te specifikuara ne Nenin 2;

(e) termi "autoritet kompetent" nenkupton ministrin, ministrat apo autoritete te tjere korrespondues pergjegjes per deget dhe skemat e sigurimeve shoqerore ne te gjitha apo ndonje pjese te territorit te seciles Pale Kontraktuese,

(f) termi "institucion" nenkupton organin apo autoritetin pergjegjes per zbatimin e te gjitha apo pjeseve te legjislacionit te seciles Pale Kontraktuese;

(g) termi "institucion kompetent" nenkupton institucionin qe eshte kompetent sipas legjislacionit te zbatueshem;

(h) termat "perfitim" dhe "pension" nenkuptojne te gjitha perfitimet ose pensionet perfshire te gjitha komponentet tyre te dhena jashte fondeve publike si dhe te gjitha rritjet, ndihmat e rivleresimit apo ndihmat shtese, nese nuk specifikohet ndryshe ne Marreveshje;

(i) termi "vendbanim" nenkupton vendbanimin e zakonshem;

(j) termi "qendrim" nenkupton vendbanimin e perkohshem;

(k) termi "periudhe sigurimi" nenkupton periudhat e kontributeve, veprimtarine profesionale ose vendbanimin dhe periudhat ekuivalente te plotesuara sipas legjislacionit te njeres Pale Kontraktuese;

(l) termi "punonjes kufitar" nenkupton nje person te punesuar i cili eshte marre ne pune ne territorin e njeres prej Paleve Kontraktuese dhe banon ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese ku ai normalisht kthehet çdo dite ose te pakten nje here ne jave;

(m) termi "refugjat" ka kuptimin e dhene per te ne Nenin 1 te Konventes mbi Statusin e Refugjateve, te nenshkuar ne Gjeneve me 28 Korrik 1951 dhe ne Nenin 1, paragrafi 2, te Protokollit mbi Statusin e Refugjateve te 31 Janarit 1967;

(n) termi "person pa shtet " ka kuptimin qe i eshte dhene ne Nenin 1 te Konventes mbi Statusin e Personave pa Shtet, te nenshkuar ne Nju Jork me 28 Shtator 1954;

(o) termi "pjesetare te familjes" nenkupton personat e percaktuar, ose te njohur si te tille nga legjislacioni i zbatuar nga instutucioni kompetent;

2. Terma dhe shprehje te tjera qe jane perdorur ne kete Marreveshje do te kene kuptimet qe u jane dhene atyre respektivisht ne legjislacionin e seciles Pale Kontraktuese.

## Neni 2

### Shtrirja materiale

#### Alternativa 1:

1. Kjo Marreveshje do zbatohet

(a) Persa i perket x, ndaj legjislacionit qe drejton

(i) ...

(ii) ...

(b) Per sa i perket y, ndaj legjislacionit qe drejton

(i) ...

(ii) ...

*(liste e skemave ose ligjeve qe te dyja Palet Kontraktuese deshirojne te rregullojne sipas kesaj Marreveshjeje)*

Alternativa 2:

1. 1. Kjo Marreveshje do te zbatohet ne te gjitha skemat e sigurimeve shoqerore dhe skemat speciale, si kontribuese dhe jo-kontribuese, qe drejtojne:
  - a. (a) ...
  - a. (b) ...
  - b. (c) ...

*(lista e perfitimeve qe te dyja Palet Kontraktuese deshirojne te rregullojne sipas kesaj Marreveshjeje)*

2. Objekt i paragrafit 3 me poshte, kjo Marreveshje gjithashtu do te zbatohet per çdo legjislacion qe i ze vendin, zevendeson, amendon, shton ose konsolidon legjislacionin e specifikuar ne paragrafin 1 me siper.
3. Kjo Marreveshje nuk zbatohet per legjislacionin qe fut nje skeme te re te sigurimeve shoqerore.

### **Neni 3**

Shtrirja personale

Alternativa 1:

Perveçse kur parashikohet ndryshe, kjo Marreveshje do te zbatohet ndaj te gjithe personave qe jane ose kane qene objekt i legjislacionit te njeres apo te te dyja



Paleve Kontraktuese si dhe ndaj anetareve te familjeve dhe trashegimtareve te ketyre personave per sa kohe te drejtat e tyre rrjedhin nga keta persona.

Alternativa 2:

Perveçse kur parashikohet ndryshe, kjo Marreveshje do te zbatohet ndaj te gjithë vendasve te te dyja Paleve Kontraktuese, personave refugjate dhe atyre pa shtet te cilet jane objekt i legjislacionit te njeres apo te dyjave Paleve Kontraktuese si dhe ndaj anetareve te familjes dhe trashegimtareve te ketyre personave persa kohe te drejtat e tyre rrjedhin nga keta persona.

**Neni 4**

Trajtim i barabarte

1. 1. Perveç rastit kur parashikohet ndryshe ne kete Marreveshje, personat e meposhtem kur banojne ne territorin e njeres Pale Kontraktuese do te kene te njejtat te drejta dhe detyrime sipas legjislacionit te asaj Pale Kontraktuese si nenshtetasit e saj:
  - a. (a) vendasit e Pales tjeter Kontraktuese;
  - a. (b) personat refugjate dhe pa shtet;
  - (c) anetaret e familjes dhe trashegimtares, pavaresisht nga kombesia e tyre, e personave te permendur ne nenparagrafet (a) dhe (b) persa i perket te drejtave qe rrjedhin nga persona te tille.

2. Dispozitat e paragrafit 1 te ketij neni nuk do te prekin legjislacionin e njeres Pale Kontraktuese perderisa ky ka te beje me pjesemarrjen ne administraten e sigurimeve shoqerore ose anetaresine e gjykatave te sigurimeve shoqerore.

## Neni 5

### Eksportimi i perfitimeve

1. Perveçse kur parashikohet ndryshe ne kete Marreveshje, çdo dispozite e legjislacionit te njeres Pale Kontraktuese qe kufizon pagesen e perfitimeve vetem per shkak se nje person banon jashte ose mungon ne territorin e kesaj Pale Kontraktuese, nuk do te zbatohet ndaj personave qe banojne ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese.

2. Dispozitat e paragrafit 1 me siper nuk do te zbatohen ndaj perfitimeve qe vijojne:

a. (a) perfitime papunesie;

(b) perfitime te veçanta te dhena si asistence ose ne rast nevojje.

## Neni 6

### Parandalimi i mbivendosjes te perfitimeve

1. Te gjithë dispozitat e legjislacionit te njeres Pale Kontraktuese qe kane si qellim reduktimin, pezullimin ose terheqjen e perfitimeve ne rastet kur ka nje mbivendosje me perfitime te tjera ose te ardhura te tjera, ose per shkak te nje veprimtarie profesionale, do te zbatohen gjithashtu ndaj nje perfituesi ne lidhje me perfitimet e fituara sipas legjislacionit te Pales tjeter Kontraktuese ose ne lidhje me te ardhura te marra, ose nje pune te kryer ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese.

2. Paragrafi 1 nuk do zbatohet ndaj perfitimeve ne lidhje me invaliditetin, pleqerine, vdekjen (grante) ose semundjeet profesionale qe jepen nga institucionet e te dyja Paleve Kontraktuese, ne perputhje me dispozitat e Nenit 21 dhe Nenit 26 (b).

## PJESA II

### LEGJISLACIONI I ZBATUESHEM

#### Neni 7

##### Rregulla te pergjithshme

Pervecse kur parashikohet ndryshe ne kete Pjese:

(a) nje person qe eshte i punesuar ne territorin e njeres Pale Kontraktuese do te jete, ne lidhje me kete punesim, objekt i legjislacionit te vetem kesaj Pale Kontraktuese, edhe nese banon ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese, ose punedhenesi i tij apo selia e punedhenesit te tij ndodhet ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese;

(b) nje person i vetepunesuar i cili ndjek profesionin e tij ne territorin e njeres Pale Kontraktuese do te jete objekt i legjislacionit te kesaj Pale Kontraktuese, edhe nese banon ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese;

(c) punonjesit civile te njeres Pale Kontraktuese dhe personat e menduar si te tille do te jene objekt i legjislacionit te Pales Kontraktuese ne administraten e te ciles ata jane punesuar.

#### Neni 8

##### Punonjesit e derguar

1. Nje person qe eshte i punesuar ne territorin e njeres Pale Kontraktuese dhe i cili eshte derguar nga punedhenesi i tij ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese per te kryer nje pune, ndersa qendron ne punesim te paguar me te njejtin punedhenes do te vazhdoje te jete objekt i legjislacionit te Pales Kontraktuese te pare per kohezgjatjen e kesaj pune sikur te ishte ende i punesuar ne territorin e asaj Pale Kontraktuese, me kusht qe kohezgjatja e parashikuar e punes te mos e kaloje periudhen prej 12 muajsh [24 muaj].

2. Nje person qe eshte vetepunesuar normalisht ne territorin e njeres Pale Kontraktuese dhe qe kryen pune ne territorin e Pales Kontraktuese tjeter do te vazhdoje te jete objekt i legjislacionit te Pales Kontraktuese te pare, me kusht qe kohezgjatja e parashikuar e punes te mos i kaloje 12 muaj [24 muaj].

## Neni 9

### Personeli i ndermarrjeve te transportit nderkombetar

Nje person qe eshte anetar i personelit udhetues apo fluturues se nje ndermarrjeje e cila, me qira apo pagese apo per llogari te saj, vepron ne sherbimet e transportit nderkombetar per pasagjere apo mallra me hekurudhe, rruge, ajer apo udhe te brendshme ujore dhe e ka seline e saj ne territorin e njeres Pale Kontraktuese do te jete objekt i legjislacionit te asaj Pale, me kufizimet ne vijim:

(i) kur ndermarrja ne fjale ka nje dege apo perfaqesi te perhershme ne territorin e nje Pale Kontraktuese tjeter nga ajo ne te cilen ka seline e saj, nje person qe eshte i punesuar nga nje dege e tille ose perfaqesi e perhershme do te jete objekt i legjislacionit te Pales Kontraktuese ne territorin e se ciles eshte vendosur nje dege e tille apo perfaqesi e perhershme;

(ii) nese nje person eshte punesuar kryesisht ne territorin e Pales Kontraktuese ne te cilen banon, ai do te jete objekt i legjislacionit te asaj Pale Kontraktuese , edhe nese ndermarrja qe e puneson ate nuk ka seli apo dege apo perfaqesi te perhershme ne territorin e saj.

## Neni 10

### Anetaret e ekuipazhit te anijeve

#### Alternativa 1:

1. Nje person i cili eshte punesuar ne bordin e nje anijeje me flamur te nje Pale Kontraktuese do te jete objekt i legjislacionit te asaj Pale Kontraktuese.

#### Alternativa 2:

1. Nje person i cili eshte punesuar ne bordin e nje anijeje me flamurin e nje Pale Kontraktuese dhe i cili eshte banor ne territorin e asaj Pale Kontraktuese, do te jete objekt i legjislacionit te asaj Pale Kontraktuese, me kusht qe selia e individit qe e puneson ate te ndodhet ne territorin e saj.

2. Dispozitat e Nenit 8 do te zbatohen *mutatis mutandis* ndaj nje personi qe eshte derguar te punoje ne bordin e nje anijeje me flamurin e njeres Pale Kontraktuese.

## Neni 11

### Misionet diplomatike dhe postet konsullore

1. Anetaret e misioneve diplomatike apo posteve konsullore te njeres Pale Kontraktuese si dhe personat e punesuar ne sherbimin privat te zyrtareve te misioneve a posteve te tilla, te cilet jane derguar ne Shtetin prites, do te jene objekt i legjislacionit te Shtetit dergues
2. *Personat e punesuar te permendur ne paragrafin e mesiperm te cilet nuk jane te derguar, do te jene objekt i legjislacionit te Shtetit prites. Megjithate, nese ata jane vendas te Shtetit dergues ata mund te zgjedhin te zbatojne legjislacionin e atij Shteti. Nje e drejte e tille zgjedhjeje mund te ushtrohet brenda tri muajsh pas dates ne te cilen personi ne fjale angazhohet nga misioni diplomatik apo posti konsullor apo hyn ne sherbimin privat te nje zyrtari te ketij misioni diplomatik apo posti konsullor, sipas rastit.*

## Neni 12

### Perjashtimet nga dispozitat e Neneve nga 7 ne 11

Autoritetet kompetente te te dyja Paleve Kontraktuese mund te bien dakord per perjashtime nga dispozitat e Neneve 7 ne 11 ne interesin e ndonje personi apo kategorie personash, me kusht qe personi apo personat e prekur te jene objekt i legjislacionit te njeres Pale Kontraktuese.

## PJESA III

### **DISPOZITA TE VEÇANTA NE LIDHJE ME KATEGORITE E NDYSHME TE PERFITIMEVE**

#### **SEKSIONI 1**

#### **PERFITIMET PER SEMUNDJE DHE LEJE LINDJE**

## Neni 13

### Grumbullimi i periudhave te sigurimit

1. Nëse legjislacioni i njërës Pale Kontraktuese jep të drejte për përfitime me kusht plotësimin e periudhës së sigurimit, institucioni kompetent i asaj Pale do të marrë parasysh, në shtrirjen e nevojshme, periudhat e sigurimit të plotësuar në legjislacionin e Palës Kontraktuese tjetër, për atë kohë sa ato nuk mbivendosen, si të ishin periudha sigurimi të plotësuar në legjislacionin e Palës së parë.

[ 2. Përderisa bëhet fjalë për të drejtën për përfitime ditore në kesh në rast semundjeje a lejelindjeje, grumbullimi i përmendur në paragrafin 1 të këtij Neni do të zbatohet vetëm nëse personi i interesuar ka qenë i punësuar në një punë fitimprurëse në territorin e Palës Kontraktuese sipas legjislacionit të së cilës është bërë zbatimi. ]

## **Neni 14**

### Qendrimi në Palen tjetër Kontraktuese

1. Personat që plotësojnë kushtet për të drejtë përfitimesh në legjislacionin e njërës prej Palëve Kontraktuese dhe kushtet e të cilëve kërkojnë dhënien e menjëhershme të përfitimeve gjatë qëndrimit në territorin e Palës Kontraktuese tjetër, do të marrin përfitime në natyrë, të parashikuara në shpenzimet e institucionit kompetent nga institucioni i vendit të qëndrimit në përputhje me dispozitat e legjislacionit të zbatuar nga institucioni i fundit, sikur këta persona të ishin regjistruar në të.

2. Pajisja me proteza, aparate të mëdha dhe përfitime të tjera të konsiderueshme në natyrë do të jenë objekt marrëveshjeje paraprake të institucionit kompetent, në rast se dhënia e përfitimit nuk mund të shtyhet pa rrezik serioz për jetën ose shëndetin e personit të interesuar.

3. Përfitimet në kesh do të paguhën nga institucioni kompetent në përputhje me dispozitat e legjislacionit që zbaton ai.

4. Dispozitat e paragrafeve paraprires do të zbatohen, *mutatis mutandis*, për anëtarët e familjes në lidhje me përfitimet në natyrë.

## **Neni 15**

### Banimi në Palen tjetër Kontraktuese

1. Personat që banojnë në territorin e njërës Pale Kontraktuese dhe plotësojnë kushtet për të drejtë përfitimesh në legjislacionin e Palës tjetër Kontraktuese, do të marrin, në territorin e Palës Kontraktuese ku banojnë, përfitime në natyrë të

parashikuara ne shpenzimet e institucionit kompetent nga institucioni i vendit te qendrimit ne perputhje me dispozitat e legjislacionit te zbatuar nga institucioni i fundit, sikur sikur keta persona te ishin regjistruar ne te.

2. Pajisja me proteza, aparate te medha dhe perfitime te tjera te konsiderueshme ne natyre do te jene objekt marreveshjeje paraprake te institucionit kompetent, ne rast se dhenia e perfitimit nuk mund te shtyhet pa rrezik serioz per jeten ose shendetin e personit te interesuar.

3. Perfitimet ne kesh do te paguhen nga institucioni kompetent ne perputhje me dispozitat e legjislacionit qe zbaton ai.

4. Dispozitat e paragrafeve paraprires do te zbatohen, *mutatis mutandis*, ne lidhje me perfitimet ne natyre per anetaret e familjes qe banojne ne territorin e Pales Kontraktuese tjeter per sa kohe ata nuk kane te drejte per perfitime te tilla qe rrjedhin nga nje veprimtari profesionale nen legjislacionin e asaj Pale Kontraktuese.

## Neni 16

### Punetoret kufitare

Nje punetor kufitar mund te marre gjithashtu perfitime ne territorin e Pales Kontraktuese ku eshte vendosur institucioni kompetent. Te tilla perfitime do te parashikohen nga institucioni kompetent ne perputhje me legjislacionin e asaj Pale, sikur personi i interesuar te ishte banor ne territorin e saj. Anetaret e familjes se tij mund te marrin perfitime nen te njejtat kushte; sidoqofte, marrja e perfitimeve te tilla, pervec rasteve urgjente, do te jete objekt marreveshjeje ndermjet autoriteteve kompetente te te dyja Paleve, ose ne mungese te saj, autorizimi paraprak te institucionit kompetent.

## Neni 17

### Pensionistet dhe anetaret e familjeve te tyre

1. Nje pensionist qe merr pension sipas legjislacionit te te dy Paleve Kontraktuese do te marre perfitime ne natyre sipas legjislacionit te Pales Kontraktuese ne territorin e se ciles banon, si te te ishte pensionist vetem sipas legjislacionit te kesaj Pale.

2. Nje pensionist qe merr pension sipas legjislacionit te nje Pale Kontraktuese do te kete te drejte per perfitime ne natyre ne kushtet kur do te kishte te

drejte per to sikur te ishte banor ne territorin e Pales se meparshme. Perfitimet ne natyre do te parashikohen nga institucioni i vendit te banimit, ne perputhje me dispozitat e legjislacionit qe zbaton ai, sikur pensionisti te kishte te drejte per te tilla perfitime sipas ketij legjislacioni; sidoqofte, kostoja do te mbulohet nga institucioni kompetent i Pales tjeter.

3. Kur anetaret e familjes se nje pensionisti qe merr nje pension sipas legjislacionit te njeres Pale Kontraktuese jane banues ne territorin e Pales Kontraktuese tjeter nga ajo ne te cilen banon vete pensionisti, ata do te marrin perfitime ne natyre sikur pensionisti te ishte banues ne te njejtin territor. Perfitimet ne natyre do te jepen nga institucioni i vendit te banimit te anetareve te familjes, ne perputhje me dispozitat e legjislacionit qe ai zbaton; megjithate, kostoja do te perballohet nga institucioni i vendit te banimit te pensionistit.

4. Dispozitat e Nenit 14 dhe Nenit 15, paragrafi 4, do te zbatohen, *mutatis mutandis*.

## Neni 18

### Institucionet e vendit te qendrimit ose banimit

Perfitimet e permendura ne Nenet 14 dhe 15 dh ne Nenin 17, paragrafi 2, do te jepen:

ne x  
nga ....., \*)

ne y

(\*) Nese ka dy apo me teper skema ne njeren Pale Kontraktuese, skeme te pergjithshme ose, ne mungese te tyre, skeme per punonjesit e industrise.)

## Neni 19

### Rimbursimi

#### Alternativa 1:

1. Institucioni kompetent do te kompensoje shumen aktuale te perfitimeve ne natyre te dhena ne emer te tij nga institucioni i vendit te qendrimit ose banimit sipas dispozitave te Neneve 14 dhe 15 dhe Nenit 17, paragrafet 2 dhe 3.



2. Autoritetet kompetente te te dyja Paleve Kontraktuese mund te bien dakord ne rregullime te tjera per kompensimet, ose mund te bien dakord te mos kete kompensime ndermjet institucioneve te interesuara.

Alternativa 2:

1. Kompensimi i kostos se perfitimeve ne natyre te dhena sipas Nenit 14, Nenit 15 dhe Nenit 17, paragrafi 2 dhe 3 do te percaktohen dhe kryhen ne perputhje me rregulloret per te cilat do te bihet dakord nga autoritetet kompetente te te dyja Paleve Kontraktuese.

2. Autoritetet kompetente te te dyja Paleve Kontraktuese mund te bien dakord qe nuk do te kete kompensime ndermjet institucioneve te sigurimeve te interesuara.

## SEKSIONI 2

### PERFITIMET E INVALIDITETIT, TE PLEQERISE DHE TE TRASHEGIMTAREVE

#### Neni 20

#### Grumbullimi i periudhave te sigurimit

1. Ne rastin kur legjislacioni i njeres Pale Kontraktuese e kushtezon te drejten per perfitime me plotesimin e periudhave te sigurimit, institucioni qe e zbaton kete legjislacion do te marre parasysh ne shtrirjen e nevojshme, periudhat e sigurimit te plotesuara sipas legjislacionit pergjegjes te Pales Kontraktuese tjeter, per sa kohe sa ato nuk mbivendosen, sikur te ishin periudha te plotesuara sipas legjislacionit te Pales se pare.

2. Ne rastin kur legjislacioni i njeres Pale Kontraktuese e kushtezon dhenien e disa perfitimeve me plotesimin e nje fare periudhe ne nje aktivitet te mbuluar nga nje skeme e posaçme ose ne nje aktivitet a pune te caktuar, vetem periudhat e plotesuara sipas nje skeme pergjegjese, ose, ne mungese te nje skeme te tille, ne te njejtin aktivitet a pune, sipas rastit, nen legjislacionin e Pales Kontraktuese tjeter, do te merren ne konsiderate per percaktimin e te drejtes per te tilla perfitime.

3. Ne rastin kur legjislacioni i njeres Pale Kontraktuese e kushtezon dhenien perfitimeve me personin e interesuar ose, ne rastin e perfitimit te trashgegimtareve, me personin e vdekur qe ka qene objekt i ketij legjislacioni ne kohen kur ka ndodhur aksidenti, nje kusht i tille do te gjykohet se duhet plotesuar, nese personi i interesuar a i vdekur, sipas rastit, ka qene ne ate kohe objekt i legjislacionit te Pales Kontraktuese tjeter, ose, ne mungese te tij, nese personi i interesuar a

trashegimtari mund te kerkojne perfitimet pergjegjese sipas legjislacionit te Pales Kontraktuese tjeter.

4. Ne rastin kur legjislacioni i njeres Pale Kontraktuese parashikon se periudha e pageses se nje pensioni eshte e llogaritshme per percaktimin e te drejtes se nje perfitimi, institucioni kompetent i asaj Pale do te marre parasysh per kete qellim çdo periudhe gjate se ciles eshte paguar nje pension sipas legjislacionit te Pales Kontraktuese tjeter.

5. Ne rastin kur legjislacioni i njeres Pale Kontraktuese e kushtezon dhenien e perfitimeve te invaliditetit me personin e interesuar qe ka marre perfitime semundjeje ne kesh ose qe ka qene i paafte per pune gjate nje periudhe te caktuar, çdo periudhe gjate se ciles, sipas paaftesise per pune, ai ka marre nen legjislacionin e Pales Kontraktuese tjeter, perfitime semundjeje ne kesh, ose ne vend te tyre, ka vazhduar te marre nje pagese a rroge, merret ne konsiderate.

## Neni 21

### Dhenia e perfitimeve

#### Alternativa 1: ( Llogaritja "Pro rata temporis" )

1. Ne rastin kur nje person ka qene ne vazhdimesi ose ne menyre te alternuar objekt i legjislacionit te te dy Paleve Kontraktuese, institucioni i seciles Pale do te percaktoje, ne perputhje me legjislacionin qe zbaton, nese ky person a trashegimtaret e tij kane te drejte per perfitime, duke pasur parasysh, kur duhet, dispozitat e Nenit 20.

2. Ne rastin kur personi i interesuar ploteson kushtet e specifikuara ne paragrafin 1 te ketij Neni sipas legjislacionit te njeres Pale Kontraktuese pa pasur parasysh dispozitat e Nenit 20, institucioni kompetent i asaj Pale Kontraktuese do te llogarise perfitimet vetem mbi bazen e periudhave te plotesuara sipas legjislacionit qe zbaton.

3. Ne rastin kur personi i interesuar ploteson kushtet e specifikuara ne paragrafin 1 te ketij Neni sipas legjislacionit te njeres Pales Kontraktuese, duke marre parasysh vetem dispozitat e Nenit 20, institucioni kompetent i kesaj Pale Kontraktuese do t'i llogarise perfitimet si vijon:

- (a) institucioni kompetent do te llogarise shumen teorike te perfitimeve te pagueshme nese te gjitha periudhat e plotesuara sipas legjislacionit te te dyja Paleve Kontraktuese kane qene plotesuar vetem sipas legjislacionit qe zbaton ai institucion;
- (b) megjithate, ne rastin e perfitimeve shuma e te cilave nuk varet nga kohezgjatja e periudhave te plotesuara, kjo shume do te merret si shuma teorike e permendur ne nen-paragrafin e mesiperme;
- (c) institucioni kompetent do ta llogarise pastaj shumen aktuale te perfitimeve te pagueshme prej tij personit te interesuar ne baze te shumes teorike te llogaritur ne perputhje me dispozitat e nen-paragrafit a ose te nen-paragrafit b te ketij paragrafi, sipas rastit, dhe ne proporcion me marredhenien ndermjet periudhave te plotesuara para se te ndodhte aksidenti sipas legjislacionit qe zbaton dhe totalit te periudhave te plotesuara para se te ndodhte aksidenti sipas legjislacionit te te dyja Paleve Kontraktuese;
- (d) nese totali i periudhave te plotesuara sipas legjislacionit te te dyja Paleve Kontraktuese para se te ndodhte aksidenti e tejkalon periudhen maksimale te kerkuar nga legjislacioni i njeres Pale per marrjen e perfitimit te plote, institucioni i asaj Pale, kur zbaton dispozitat e nen-paragrafit a te ketij paragrafi, do te marre parasysh kete periudhe maksimale ne vend te totalit te periudhave te plotesuara, pa qene i detyruar, megjithate, te jape perfitime me te medha se sa perfitimi i plote qe jepet per te ne legjislacionin qe zbaton.
7. 4 Ne rastin kur legjislacioni i njeres Pale Kontraktuese parashikon qe shuma e perfitimit me perjashtim te perfitimit te burimeve te kontrolluara qe sigurojne nje te ardhur minimale, do te varioje sipas numrit te anetareve te familjes, institucioni kompetent i asaj Pale do te marre parasysh gjithashtu anetaret e familjes banore ne territorin e Pales Kontraktuese tjetere sikur ata te ishin banore ne territorin e Pales se pare.

Alternativa 2: ( Llogaritja e drejtperdrejte)

1. Ne rastin kur, sipas legjislacionit te njeres Pale Kontraktuese e drejta per perfitime ekziston gjithashtu edhe pa zbatuar Nenin 20, institucioni kompetent i asaj Pale do te percaktoje shumen e perfitimeve te pagueshem vetem mbi bazen e periudhes se sigurimit te plotesuar sipas ketij legjislacioni.

2. Ne rastin kur, sipas legjislacionit te njeres Pale Kontraktuese e drejta per perfitime ekziston vetem duke zbatuar Nenin 20, institucioni kompetent i asaj

Pale do te percaktoje shumen e perfitimit te pagueshem vetem mbi bazen e periudhave se sigurimit te plotesuara dhe dispozitave te meposhtme:

(a) perfitime ose pjese e perfitimeve, shuma e te cileve, sipas legjislacionit te njeres Pale Kontraktuese, nuk varet nga kohezgjatja e periudhave te sigurimit te plotesuara, do te llogaritet ne proporcion me raportin e kohezgjatjes se periudhave te sigurimit te marra parasysh per llogaritje sipas ketij legjislacioni deri ne 30 vjet, por jo me shume se deri te shuma e plote.

(b) ne rastin kur, sipas legjislacionit te njeres Pale Kontraktuese, periudhat e ndodhjes se aksidentit do te merren parasysh per llogaritjen e invaliditetit ose perfitimeve te trashegimtareve, keto periudha do te llogariten vetem ne proporcion me raportin e kohezgjatjes se periudhave te sigurimit qe duhen marre ne konsiderate per llogaritje sipas ketij legjislacioni deri ne dy te tretat e kohes ndermjet dates kur personi i interesuar ka arritur moshen 16-vjeçare dhe dates kur ka ndodhur aksidenti, por jo me shume se deri te periudha e plote.

(c) nen-paragrafi a nuk zbatohet per:

- (i) perfitime qe rrjedhin nga sigurime suplementare,
- (ii) perfitime te burimeve te kontrolluara qe sigurojne nje te ardhur minimale.

3. Ne rastin kur legjislacioni i njeres Pale Kontraktuese parashikon qe shuma e perfitimeve, me perjashtim te perfitimeve te burimeve te kontrolluara per te siguruar nje te ardhur minimale, do te ndryshoje sipas numrit te pjesetareve te familjes, institucioni kompetent i asaj Pale do te marre parasysh edhe numrin e pjesetareve te familjes qe banojne ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese, sikur te ishin banues ne territorin e Pales se pare.

## **Neni 22**

### Periudha sigurimi me pak se nje vjeçare

1.1 Pavaresisht nga dispozitat e Nenit 21, ne rastin kur kohezgjatja totale e periudhave te sigurimit te plotesuar sipas legjislacionit te nje Pale Kontraktuese eshte me pak se nje vit dhe kur, mbi bazen vetem te ketyre periudhave, nuk ekziston e drejte per perfitime sipas ketij legjislacioni, institucioni i Pales se interesuar nuk eshte i detyruar te jape perfitime ne lidhje me periudhat ne fjale.

2. Periudhat e sigurimit te permendura ne paragrafin e meparshem do te merren parasysh nga institucioni i Pales tjeter Kontraktuese me qellim zbatimin e dispozitave te Nenit 21, (Alternativa 2 e Nenit 21), sikur keto periudha te ishin plotesuar sipas legjislacionit qe zbaton, me perjashtim te atyre te paragrafit 3 ( c ) te tij, (Alternativa 1 e Nenit 21).

### SEKSIONI 3

#### NDIHMA NE RAST VDEKJEJE

##### Neni 23

#### Grumbullimi i periudhave te sigurimit dhe dhenia e ndihmave ne rast vdekjeje

1. Nese legjislacioni i njeres Pale Kontraktuese e kushtezon te drejten per perfitime me plotesimin e periudhave te sigurimit, institucioni kompetent i asaj Pale, ne shtrirjen e nevojshme, do te marre parasysh periudhat e sigurimit te plotesuara sipas legjislacionit te Pales tjeter Kontraktuese, per sa kohe ato nuk mbivendosen, si te ishin periudha te plotesuara sipas legjislacionit te Pales se pare.

2. Nese nje person vdes ne territorin e njeres Pale Kontraktuese, vdekja e tij do te trajtohet, per qellimin e ndonje kerkese per ndihme vdekjeje, sipas legjislacionit te njeres Pale Kontraktuese, sikur ajo te kishte ndodhur ne territorin e asaj Pale Kontraktuese.

3. Po te kishte te drejte per nje ndihme vdekjeje sipas legjislacionit te te dyja Paleve Kontraktuese, ose sipas kesaj Marreveshjeje ose :

a. (a) ndihma do te paguhet vetem sipas legjislacionit te Pales Kontraktuese ne territorin e se ciles ndodh vdekja; ose

(b) nese vdekja nuk ndodh ne territorin e njeres Pale Kontraktuese, ndihma do te paguhet vetem sipas legjislacionit te Pales Kontraktuese nen legjislacionin e se ciles personi mbi bazen e sigurimit te te cilit percaktohet e drejta per ndihme, ishte siguruar se fundi para vdekjes.

## SEKSIONI 4

### PERFITIMET E DEMTIMEVE DHE SEMUNDJEVE PROFESIONALE

#### Neni 24

##### Ekspozimi ndaj te njejtit risk ne te dy Palet Kontraktuese

1. 1. Ne rastin kur nje person merr nje semundje profesionale pas hyrjes ne nje pune qe shkakton kete semundje sipas legjislacionit te te dy Paleve, çdo perfitim per te cilin mund te kete te drejte ai ose trashëgimtaret e tij, do te jepet vetem ne perputhje me legjislacionin e te fundit prej Paleve Kontraktuese kushtet e se ciles plotesohen duke marre parasysh, kur eshte e mundur, dispozitat e paragrafeve 2 deri 4 te ketij Neni.

2. Nese legjislacioni i njeres Pale Kontraktuese e kushtezon dhenien e perfitimeve per semundje profesionale nga fakti se semundja ne fjale eshte diagnostikuar se pari ne territorin e saj, keto kushte do te gjykohen si te plotesuara nese semundja u diagnostikua se pari ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese.

3 Nese legjislacioni i njeres Pale Kontraktuese shprehimisht ose jo e kushtezon dhenien e perfitimit per semundje profesionale me faktin se semundja ne fjale eshte diagnostikuar brenda nje periudhe te specifikuar pas perfundimit te aktivitetit qe shkakton nje semundje te tille, institucioni kompetent i kesaj Pale Kontraktuese, pasi eshte vertetuar koha gjate se ciles eshte kryer aktiviteti ne fjale ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese, ne shtrirjen e nevojshme, do te marre parasysh nje aktivitet te ngjashem sipas legjislacionit te Pales Kontraktuese tjeter, sikur te ishte ndermarre sipas legjislacionit te Pales Kontraktuese te pare.

4. Nese legjislacioni i njeres Pale Kontraktuese shprehimisht ose ne menyre te nenkuptuar e ben dhenien e ndihmes per semundje profesionale objekt te kushtit qe nje aktivitet pergjegjes per shkaktimin e semundjes ne fjale eshte kryer per nje periudhe te caktuar, institucioni kompetent i asaj Pale Kontraktuese, ne shtrirjen e nevojshme, do te marre parasysh periudhat gjate te cilave nje profesion i tille eshte kryer ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese per efekt llogaritjesh.

Alternativa 1:

5. Ne rastet e pneumokoniosis sklerogjenike,

Alternativa a:

Kostoja e perfitimeve ne kesh

Alternativa b:

kostoja e pensioneve ne lidhje me semundjen profesionale do te shperndahet ndermjet Paleve Kontraktuese, ne proporcion me marredhenien ndermjet kohezgjatjes se periudhave te plotesuara nen legjislacionin e seciles Pale Kontraktuese dhe kohezgjatjen totale te periudhave te plotesuara nen legjislacionin e te dyja Paleve Kontraktuese.

Alternativa 2:

5. Ne rastet e pneumokoniosis sklerogjenike, institucioni kompetent i seciles Pale Kontraktuese do te jape pension ne proporcion me marredhenien ndermjet kohezgjatjes se periudhave te sigurimit te permendura ne Nenin 20 te plotesuara nen legjislacionin e seciles Pale Kontraktuese dhe kohezgjatjes totale te periudhave te plotesuara nen legjislacionin e te dyja Paleve Kontraktuese.

## **Neni 25**

### Banimi apo qendrimi ne Palen tjeter Kontraktuese

1. Personat qe kane pesuar nje demtim profesional ose kane nje semundje profesionale, te cilet banojne apo qendrojne ne territorin e nje Pale Kontraktuese tjeter nga ajo e institucionit kompetent, do te marrin ne territorin e asaj Pale Kontraktuese perfitime ne natyre te dhena me shpenzimet e institucionit kompetent nga institucioni i vendit te banimit apo qendrimin ne perputhje me dispozitat e legjislacionit qe institucioni i fundit zbaton, sikur keta punonjes te ishin te regjistruar ne te.

2. Perfitimet ne kesh do te paguhen nga institucioni kompetent ne perputhje me dispozitat e legjislacionit qe ai zbaton.

4. Perfitimet e parashikuara ne paragrafin 1 do te jepen

ne x

nga .....,  
ne y  
nga .....

5. Per rimbursimin e kostos se perfitimeve ne natyre te parashikuar sipas paragrafit 1, dispozitat e Nenit 18 do te zbatohen *mutatis mutandis*.

## Neni 26

### Rendimi i semundjes profesionale per te cilen jane dhene perfitimet

Ne rast se nje person qe ka nje semundje profesionale ka marre ose po merr kompensim nga institucioni i njeres Pale Kontraktuese dhe, ne rastin e keqesimit te gjendjes se tij, kerkon perfitime nga institucioni i Pales tjeter Kontraktuese, do te zbatohen dispozitat e meposhtme :

(a) nese personi i interesuar nuk ka kryer, sipas legjislacionit te Pales Kontraktuese te dyte, nje profesion qe shkakton ose rendon semundjen ne fjale, institucioni i Pales se pare do te perballoje kostot e perfitimit, duke e marre parasysh keqesimin, ne perputhje me dispozitatat e legjislacionit qe ky institucion zbaton;

(b) nese personi ne fjale ka kryer nje pune te tille sipas legjislacionit te Pales Kontraktuese te dyte, institucioni kompetent i Pales Kontraktuese do te perballoje kostot e perfitimit, duke mos e marre parasysh keqesimin, sipas dispozitave te legjislacionit qe zbaton: institucioni kompetent i Pales Kontraktuese te dyte do t'i jape punonjesit nje perfitim shtese shuma e se cilit do te jete e barabarte me diferencen ndermjet shumes se perfitimit qe i perket pas keqesimit dhe shumes se perfitimit qe, ne perputhje me dispozitat e legjislacionit qe ky institucion zbaton, i detyrohej para keqesimit nese semundja ne fjale eshte marre nen legjislacionin e asaj Pale Kontraktuese.

## SEKSIONI 5

### PERFITIMET E PAPUNESISE

## Neni 27



### Grumbullimi i periudhave te sigurimit

1. Nese legjislacioni i njeres Pale Kontraktuese e kushtezon te drejten per perfitim me plotesimin e periudhave te sigurimit, institucioni kompetent i asaj Pale do te marre parasysh, ne shtrirjen e nevojshme, periudhat e sigurimit te plotesuara nen legjislacionin korrespondues te Pales tjeter Kontraktuese, per aq sa ato nuk mbivendosen, sikur te ishin periudha te plotesuara nen legjislacionin e Pales se pare.

2. Dispozitat e paragrafit parapriles te ketij neni do te zbatohen *mutatis mutandis* kur legjislacioni i njeres Pale Kontraktuese parashikon qe kohezgjatja e periudhes per te cilen mund te jepen perfitime varet nga kohezgjatja e periudhave te plotesuara.

### **Neni 28**

#### Punonjesit kufitare

1. Nje punonjes kufitar qe eshte pjeserisht apo perkohesisht i papune ne ndermarrjen qe e puneson do te kete te drejte te perfitoje ne perputhje me dispozitat e legjislacionit te Pales Kontraktuese ne territorin e se ciles ndodhet ndermarrja sikur te banonte ne territorin e asaj Pale; keto perfitime do te jepen nga institucioni kompetent.

#### Alternativa 1

2. Nje punonjes kufitar i cili eshte plotesisht i papune do te kete te drejte te perfitoje ne perputhje me dispozitat e legjislacionit te Pales Kontraktuese ne territorin e se ciles banon sikur te kishte qene objekt i atij legjislacioni ku ka qene punesuar per here te fundit; ky perfitim do te jepet nga institucioni i vendit te banimit me shpenzimet e tij.

#### Alternativa 2:

2. Nje punonjes kufitar qe eshte plotesisht i papune do te kete te drejte te perfitoje ne perputhje me dispozitat e Pales Kontraktuese ne territorin e se ciles ndodhet ndermarrja qe e ka punesuar ate per here te fundit, edhe nese ai banon ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese. Keto perfitime do te jepen nga institucioni i vendit te banimit me shpenzimet e institucionit kompetent te Pales Kontraktuese ne territorin e se ciles ndodhet ndermarrja.
3. Nje punonjes kufitar s'mund te kerkoje perfitime nen legjislacionin e Pales Kontraktuese ne territorin e se ciles ai banon ndersa ka te drejte per perfitime sipas dispozitave te paragrafit 1.

## SEKSIONI 6

### NDIHMAT FAMILJARE

#### Neni 29

##### Grumbullimi i periudhave te sigurimit

Nese legjislacioni i njeres Pale Kontraktuese e kushtezon te drejten per perfitime nga plotesimi i periudhave te sigurimit, institucioni kompetent do te marre parasysh, ne shtrirjen e nevojshme, periudhat e sigurimit te plotesuara sipas legjislacionit te Pales tjeter Kontraktuese, per aq sa ato nuk mbivendosen, sikur te ishin periudha sigurimi te plotesuara sipas legjislacionit te Pales se pare.

#### Neni 30

##### Dhenia e ndihmave familjare

##### Alternativa 1:

1. Personat qe jane objekt i legjislacionit te njeres Pale Kontraktuese, do te kene te drejte, ne lidhje me pjesetaret e familjes se tyre qe banojne ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese, per ndihmat familjare te parashikuara nga legjislacioni i Pales se pare Kontraktuese, sikur keta pjesetare te familjes te ishin banore te territorit te asaj Pale Kontraktuese.

2. Ndihamat familjare do te paguhen ne perputhje me dispozitat e legjislacionit te Pales Kontraktuese objekt i legjislacionit te se ciles eshte perfituesi, edhe nese perfituesi eshte banor ose i vendosur ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese. Ne kete rast, me marreveshje ndermjet institucionit kompetent dhe institucionit te vendit te banimit te pjesetareve te familjes, ndihmat familjare mund te paguhen edhe nepermjet institucionit te fundit ne emer te institucionit kompetent.

##### Alternativa 2:

1. Personat qe jane objekt i legjislacionit te njeres Pale Kontraktuese do te kene te drejte, ne lidhje me pjesetaret e familjes se tyre qe banojne ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese, per ndihma familjare te parashikuara nga legjislacioni i Pales se dyte, sikur keta persona te ishin objekt i legjislacionit te saj.

##### alternativa a

2. Ndhimat familjare do t'u paguhen anetareve te familjes nga institucioni i vendit te tyre te banimit, ne perputhje me legjislacionin qe zbaton ky institucion, me shpenzimet e institucionit kompetent, ne nje shume qe nuk tejkalon shumen e perfitimit te pagueshme nga institucioni i fundit.

*alternativa b*

2. Ne rastin kur pjesetaret e familjes se nje personi qe punon ose banon ne territorin e nje Pale Kontraktuese banojne ne territorin e Pales tjetere Kontraktuese, ndihmat familjare do t'u paguhen atyre nga dhe me shpenzimet e institucionit te vendit te tyre te banimit.

### **Neni 31**

#### **Dhenia e ndihmave familjare**

Kur e drejta per ndihma familjare ekziston ne perputhje me legjislacionin e te dyja Paleve Kontraktuese ne lidhje me te njejtin pjesetar familjeje dhe te njejten periudhe, ndihmat familjare do te jepen ne perputhje me legjislacionin e Pales Kontraktuese ne territorin e se ciles banon pjesetari i familjes dhe e drejta per perfitime familjare te detyruara ne perputhje me legjislacionin e Pales tjetere Kontraktuese nderpritet deri ne shumen e parashikuar nga legjislacioni i Pales Kontraktuese te meparshme.

## **PJESA IV**

### **DISPOZITA TE NDRYSHME**

#### **Neni 32**

#### Rregullime per administrimin dhe kooperimin

1. Autoritetet kompetente te te dyja Paleve Kontraktuese do te percaktojne masat e nevojshme administrative per zbatimin e kesaj Marreveshjeje.

2. Autoritetet kompetente te te dyja Paleve Kontraktuese do t'i komunikojne njera-tjetres, sa me shpejt qe te jete e mundur, te gjitha informacionet rreth masave te marra prej tyre per zbatimin e kesaj Marreveshjeje ose rreth ndryshimeve ne legjislacionin e tyre kombetar deri ne ate kohe nese ndryshimet prekin zbatimin e kesaj Marreveshjeje.

3. Autoritetet kompetente te te dyja Paleve Kontraktuese do te krijojne organe lidhjeje me qellim lehtesimin e zbatimit te kesaj Marreveshjeje.

5. Nese nje person qe banon ose qendron ne territorin e njeres Pale Kontraktuese ka kerkuar ose po merr perfitime, sipas legjislacionit te Pales tjeter Kontraktuese dhe nje ekzaminim mjekesor eshte i nevojshem, institucioni kompetent ose institucioni i vendit te banimit ose i vendbanimit te perkohshem te Pales Kontraktuese te pare do ta rregulloje nje ekzaminim te tille nese institucioni kompetent i Pales Kontraktuese te fundit e kerkon kete. Kostoja e ekzaminimit, ne parim, do te perballohet nga institucioni kompetent i Pales Kontraktuese qe ka kerkuar ekzaminimin.

### **Neni 33**

#### Perdorimi i gjuheve zyrtare

1. Per qellimet e zbatimit te kesaj Marreveshjeje, autoritetet dhe institucionet e te dyja Paleve Kontraktuese mund te komunikojne me njera-tjetren dhe me te gjitha Palet e interesuara, ciladoqofte vendi i tyre i rezidences, drejtperdrejt ne gjuhete e tyre zyrtare.

2. Asnje kerkese ose dokument nuk do te hidhet poshte nese eshte i shkruar ne gjuhen zyrtare te Pales tjeter Kontraktuese.

### **Neni 34**

#### **Perjashtimi nga detyrimet dhe vertetimi**

1. Nese legjislacioni i njeres Pale Kontraktuese parashikon qe çdo çertifikate ose dokument tjeter qe eshte paraqitur sipas legjislacionit te asaj Pale Kontraktuese do

te perjashtohet, teresisht apo pjesesisht, nga taksat, detyrimet ligjore, shpenzimet konsullore dhe administrative, nje perjashtim i tille do te zbatohet ndaj çdo çertifikate ose dokumenti tjetër qe paraqitet nen legjislacionin e Pales tjetër Kontraktuese ose ne perputhje me kete Marreveshje.

2. Te gjitha deklaratat, dokumentet dhe çertifikatat e çfaredo lloji qe kerkohen te paraqiten per qellimet e kesaj Marreveshjeje do te perjashtohen nga vertetimi nga autoritetet diplomatike ose konsullore.

### **Neni 35**

#### Paraqitja e nje kerkese apo apelimi

Çdo kerkese apo apelim qe, per qellime te e legjislacionit te njeres Pale Kontraktuese, i eshte paraqitur brenda nje periudhe te parashikuar nje institucioni te asaj Pale Kontraktuese, do te trajtohet sikur eshte paraqitur ne kete institucion nese eshte paraqitur brenda te njejtës periudhe ndaj nje institucioni korrespondues te Pales Kontraktuese tjetër.

### **Neni 36**

#### Pergjegjesia e nje pale te trete

Nese nje person po merr perfitime nen legjislacionin e njeres Pale Kontraktuese per llogari te nje demtimi te shkaktuar ose te ndodhur ne territorin e Pales Kontraktuese tjetër, te drejtat e institucionit pagues pergjegjes per te paguar perfitime ndaj pales se trete pergjegjese per te paguar zhdemtimet do te rregullohen ne menyren qe vijon:

- (a) ne rast se institucioni ne fjale, nen legjislacionin e zbatueshem ndaj tij, eshte zevendesuar per perfituesin ne te drejtat qe ai mund te kete ndaj pales se trete, nje zevendesim i tille do te njihet nga Pala Kontraktuese tjetër; dhe
- (b) ne rast se institucioni ne fjale ka nje te drejte direkte ndaj pales se trete, nje e drejte e tille do te njihet nga Pala tjetër Kontraktuese.

### **Neni 37**

#### Rimarrja e pagesave te padetyruara

1. Nese gjate llogaritjes ose rishikimit te perfitimit te invaliditetit, pleqerise ose te trashëgimtareve sipas dispozitave te Marreveshjes, institucioni i njeres Pale Kontraktuese i ka paguar nje perfituesi nje shume me te madhe se ç'i

takonte, ai mund t'i kerkoje institucionit te Pales tjeter Kontraktuese pergjegjese per pagesen e perfitimit korrespondues ketij personi te zbrese shumen e mbipaguar nga prapambetjet qe i detyrohen atij. Institucioni i fundit do t'ia transferoje shumen e zbritur ne kete menyre institucionit kreditor. Nese nje rimarrje e tille nuk mund te behet ne kete menyre, do te zbatohen dispozitat e paragrafit pasues.

2. Ne rastin kur institucioni njeres Pale Kontraktuese i ka paguar nje perfituesi nje shume me te madhe se ç'i takonte, ky institucion mundet, ne kushtet dhe masen e lejuar nga legjislacioni qe zbaton, t'i kerkoje institucionit te Pales tjeter Kontraktuese, pergjegjese per pagesen e perfitimit ketij personi, ta zbrese shumen e tejpaguar nga pagesat qe po i kryen atij. Institucioni i fundit do ta zbrese shumen ne masen qe kjo zbritje eshte e lejuar sipas legjislacionit qe zbaton, sikur kjo tejpagese te ishte bere prej tij, dhe do t'ia transferoje shumen e zbritur ne kete menyre institucionit kreditor.

3. Ne rastin kur institucioni i njeres Pale Kontraktuese ka bere nje parapagim perfitimi per nje periudhe gjate se ciles perfituesi kishte te drejte per perfitimin korrespondues sipas legjislacionit te asaj Pale Kontraktuese, ai mund t'i kerkoje institucionit te Pales tjeter Kontraktuese ta zbrese shumen e parapagimit nga pagesat qe i detyrohen atij per te njejten periudhe. Institucioni i fundit do ta zbrese shumen dhe do t'ia transferoje ate institucionit kreditor.

## Neni 38

### Procedurat detyruese

1. Vendimet detyruese te gjykates se njeres Pale Kontraktuese si dhe dokumentat detyrues leshuar nga nje autoritet a institucion i njeres Pale Kontraktuese, ne lidhje me kontributet e sigurimeve shoqerore dhe kerkesa te tjera, do te njihen ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese.

2. Njohja mund te refuzohet vetem nese eshte ne kundersizim me rendin publik te Pales Kontraktuese ne territorin e se ciles duhet te zbatohet vendimi a dokumenti.

3. Vendimet detyruese dhe dokumentat e njohur sipas paragrafit 1 te ketij Neni do te zbatohen ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese. Procedura e detyrimit do te jete ne perputhje me legjislacionin qe drejton detyrimin e vendimeve te tilla dhe dokumentat e Pales Kontraktuese ne territorin e se ciles behet detyrimi. Vendimi ose dokumenti do te shoqerohen nga nje çertifikate qe tregon detyrueshmerine e tij (klauzola e detyrimit).

4. Kontributet e vonuara institucionit te njeres Pale Kontraktuese, ne nje procedure falimentimi ose zgjidhjeje te detyruar ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese, do te kene te njejten perparesi si ankesat ekuivalente ne territorin e asaj Pale Kontraktuese.

## Neni 39

### Monedha e pageses

1. Pagesa e çdo perfitimi ne perputhje me kete Marreveshje mund te behet ne monedhen e Pales Kontraktuese institucioni kompetent i se ciles kryen pagesen, dhe nje pagese e tille perben nje shkarkim te plote te detyrimit ne lidhje me te cilin eshte bere pagesa.

2. Nese, nen kete Marreveshje, institucioni i njeres Pale Kontraktuese eshte pergjegjes per te paguar shuma nepermjet nje kthimi te perfitimit te dhene nga institucioni i Pales tjetere Kontraktuese, pergjegjesia e tij do te shprehet ne monedhen e Pales se dyte. Institucioni i meparshem mundet ne menyre te vlefshme te shkarkoje pergjegjesine e tij ne ate monedhe, ne rast se Palet Kontraktuese s'jane marre vesh per rregullime te tjera.

## Neni 40

### Zgjidhja e mosmarreveshjeve

1. Autoritetet kompetente te te dyja Paleve Kontraktuese do bejne te gjitha perpjekjet e arsyeshme per te zgjidhur nepermjet marreveshjes dypaleshe çdo mosmarreveshje ne lidhje me zbatimin ose interpretimin e kesaj marreveshjeje.

[2. Nese ndonje mosmarreveshje s'do mund te zgjidhet siç specifikohet ne paragrafin paraardhes, ajo do t'i paraqitet, me kerkese te autoritetit kompetent te njeres Pale Kontraktuese, nje gjykate arbitrazhi qe do te perbehet si me poshte :

(a) secila Pale Kontraktuese do te caktojte nje arbiter brenda nje muaji nga marrja e kerkeses per arbitrazh. Te dy arbitrat do te caktojne nje arbiter te trete, i cili nuk do te jete shtetas i asnjeres Pale Kontraktuese (brenda dy muajsh nga data ne te cilen Pala Kontraktuese qe ishte e fundit qe caktoi arbitrin e saj njofton Palen tjetere Kontraktuese per kete caktim);

(b) nese, brenda periudhes se parashikuar, nje Pale Kontraktuese s'arrin te caktojte nje arbiter, Pala tjetere Kontraktuese mund t'i kerkoje Presidentit te Gjykates Nderkombetare ose, ne rastin kur kombesia e tij eshte si e njeres prej Paleve Kontraktuese, Nen-Presidentit ose nje gjykatesi tjetere te asaj Gjykate qe nuk ka kombesine e asnjeres prej Paleve Kontraktuese, te beje nje emerim. Nje procedure e ngjashme do te adoptohet me kerkese te nje Pale Kontraktuese nese te dy arbitrat nuk bien dakord per arbitrin e trete.

3. Vendimi i gjykates se arbitrazhit qe do te jete detyrues per te dyja Palet Kontraktuese, do te jepet me shumice votash. Gjykata e arbitrazhit do te percaktoje rregullat e saj te procedures dhe kostot e saj do te perballohen ne menyre te barabarte nga te dyja Palet Kontraktuese.]

## PJESA V

### DISPOZITA KALIMTARE DHE PERFUNDIMTARE

#### Neni 41

Dispozita kalimtare

#### Alternativa 1:

1. Kjo marreveshje nuk do te jape te drejta per asnje periudhe para hyrjes se saj ne fuqi.
2. Te gjitha periudhat e sigurimit te plotesuara nen legjislacionin e nje Pale Kontraktuese para hyrjes ne fuqi te kesaj Marreveshjeje do te merren parasysh ne çeshtjen e percaktimit te te drejtave qe lindin nga kjo Marreveshje.
3. Objekt i paragrafit 1 te ketij neni, te drejtat mund te lindin nen kete Marreveshje edhe ne lidhje me ndonje aksident qe ka ndodhur para hyrjes ne fuqi te saj.
4. Çdo perfitim i percaktuar vetem sipas kesaj Marreveshjeje do te percaktohet, me kerkese te personit te interesuar dhe ne perputhje me dispozitat e kesaj Marreveshjeje, me efekt nga hyrja ne fuqi e kesaj Marreveshjeje, pervec se kur te drejtat e percaktuara me pare kane shkaktuar nje pagese shume globale.
5. Ne rastin kur kerkesa e permendur ne paragrafin 4 te ketij Neni paraqitet brenda dy vjetesh nga hyrja ne fuqi e kesaj Marreveshjeje, te drejtat qe rrjedhin ne perputhje me dispozitat e kesaj Marreveshjeje do te fitohen qe nga ajo date, dhe ato dispozita te legjislacionit te Pales tjetere Kontraktuese ne lidhje me humbjen ose kufizimin e te drejtave nuk do te perdoren kunder personit te interesuar.



6. Çdo perfitim që është percaktuar para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marreveshjeje nuk do të rillogaritet.

Alternativa 2:

1. Çdo e drejtë për perfitime të fituar nga një person për hyrjes në fuqi të kësaj marreveshjeje do të ruhet. Për qëllimet e këtij paragrafi, shprehja “Çdo e drejtë për perfitime të fituar” do të përfshijë çdo të drejtë që do të kishte pasur një person, por që nuk e ka kërkuar në kohë, kur një kërkesë e mëvonshme është e lejueshme.

2. Nëse, nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marreveshjeje, nuk është percaktuar ndonjë kërkesë për perfitime dhe kur e drejta për të ka dalë para kësaj date, kërkesa do të percaktohet sipas legjislacionit të zbatueshëm në datën e lindjes së të drejtës dhe do të percaktohet serish në përputhje me këtë Marreveshjeje që nga data e hyrjes në fuqi. Shuma e percaktuar sipas kësaj Marreveshjeje do të jepet që nga data e hyrjes në fuqi nëse një shumë e tillë është më e favorshme se ajo e percaktuar sipas legjislacionit të zbatuar para kësaj date.

3. Perfitimet, përveç pagesave totale, do të jenë të pagueshme në përputhje me këtë Marreveshjeje në lidhje me ngjarje që kanë ndodhur para datës së hyrjes në fuqi, përveç rastit kur një dëmtim profesional i pesuar apo një semundje profesionale e marrë para kësaj date nuk do të trajtohen, vetëm në bazë të kësaj Marreveshjeje, si dëmtim profesional apo semundje profesionale, po të mos kishin qenë trajtuar kështu sipas ndonjë legjislacioni të Marreveshjejeje në fuqi në kohën kur u pesua a u mor. Me qëllim të percaktimit të kërkesave në përputhje me këtë Marreveshjeje, do të merren parasysh, në masën e nevojshme, periudhat e sigurimit të plotësuar para datës së hyrjes në fuqi të saj.

5. Për qëllimet e paragrafit 1 dhe të fjalisë së parë të paragrafit 3 më sipër:

(a) çdo e drejtë për perfitim, me kërkesën e personit të interesuar, do të percaktohet perseri në përputhje me këtë Marreveshjeje, me efekt që nga data e hyrjes së saj në fuqi, me kusht që kërkesa të bëhet brenda dy vjetëve që nga data e hyrjes në fuqi dhe, nëse është e zbatueshme, perfitimi do të jepet me vlerën më të lartë nga data e fundit;

(b) nëse kërkesa për të percaktuar perfitimet bëhet me vonë se dy vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marreveshjeje, pagesa e perfitimit dhe e ndonjë vonese do të bëhet në përputhje me legjislacionin e interesuar.

**Neni 42**

Ratifikimi

1. Kjo Marreveshje do te ratifikohet dhe instrumentet e ratifikimit do te shkembhen sa me shpejt qe te jete e mundur.
2. Marreveshja do te hyje ne fuqi dite e pare te muajit te trete pas muajit ne te cilin shkembhen instrumentet e ratifikimit.

### **Neni 43**

#### Kohezgatja e Marreveshjes

Kjo Marreveshje do te mbetet ne fuqi per nje kohe te pacaktuar. Nje Pale Kontraktuese mund ta prishe ate ne fundin e nje viti kalendarik duke njoftuar tre muaj perpara me shkrim Palen tjeter Kontraktuese.

### **Neni 44**

#### Prishja e Marreveshjes.

1. Ne rast te prishjes se kesaj Marreveshjeje, te gjitha te drejtat fituara sipas dispozitave te saj do te ruhen.
1. 2. Te drejtat qe jane duke u fituar ne lidhje me periudhat para dates kur prishja e marreveshjes behet efektive nuk do te marrin fund per shkak te prishjes; njohja e tyre vijuese do te percaktohet me marreveshje ose, ne mungese te nje marreveshjeje te tille, nga legjislacioni qe zbaton institucioni i interesuar.

*Ne deshmi te se ciles, i nenshkruari, duke qene i autorizuar rregullisht, e ka nenshkuar kete Marreveshje.*

*Bere ne (...), me (...), ne dy kopje ne gjuhen (...) dhe (...), ku te dyja tekstet jane njesoj te vlefshem.*

**RAPORT SHPJEGUES**  
**I DISPOZITAVE MODEL PER**  
**KOORDINIMIN E SKEMAVE TE SIGURIMEVE SHOQERORE**  
**NE MARREVESHJET BILATERALE**

**Hyrje**

1. Koordinimi i skemave te sigurimeve shoqerore te vendeve te ndryshme eshte konsideruar se ka te beje me problemet specifike me te cilat ndeshen emigrantet vecanerisht si rezultat i statusit te tyre prej te huaji. Per te qene i efektshem, nje koordinim i tille duhet te trajtoje eliminimin e dispozitave diskriminuese te bazuara ne kombesine, neutralizimin e kufizimeve ne shtirjen territoriale te legjislacionit, hartimin e regjistrave kombetare te sigurimit per emigrantet dhe vendosjen e bashkepunimit ndermjet institucioneve te sigurimeve shoqerore kombetare dhe organeve pergjegjes per dhenien e perfitimeve, si dhe shperndarjen e kostove te asistences reciproke ne ceshtje administrative.

2. Koordinimi kerkon zbatimin, ne nje forme a ne nje tjeter, te kater parimeve baze te percaktuar per t'u ofruar emigranteve mbrojtje te plote:

- barazi trajtimi: ne Shtetet e lidhura nga ky instrument, emigrantet duhet te kene te njejtat te drejta dhe detyrime te sigurimeve shoqerore si banoret vendas ne te njejtat rrethana;

- percaktimi i legjislacionit te zbatueshem: ai duhet te sigurohet se emigrantet jane, ne lidhje me te njejtin aktivitet profesional, objekt i dispozitave te vetem nje vendi;

- ruajtja e te drejtave te fituara: vetem e drejta per perfitime qe eshte fituar apo po fitohet ne nje Shtet te lidhur nga instrumenti, duhet te mbetet e disponueshme nga emigranti i interesuar ne çdo Shtet tjeter;

- dhenia e perfitimeve jashte: dhenia e perfitimeve te fituara ne njerin Shtet duhet te sigurohet per perfituesit ne Shtetin tjeter te lidhur nga instrumenti.

3. Rregullat qe i takojne koordinimit jane percaktuar ne menyre te tille qe te sigurojne qe skemat e vendeve te ndryshme te jene te lidhura bashke, pa krijuar nje sistem te perbashket sigurimesh shoqerore. Nese rregullat duhet te behen te efektshme, duhen marre parasysh karakteristikat specifike te secilit organ perkates te legjislacionit. Ne menyre te veçante, eshte e nevojshme te vendoset nje lidhje

ndermjet skemave te bazuara ne sigurimin dhe skemave universale dhe te sigurohet e drejte e barabarte per perfitime niveli i te cileve nuk eshte i lidhur me kohezgjatjen e periudhave te references te plotesuara, si dhe te sigurohet se perfitime jo-kontribuese te dhena pa nje kontroll te ardhurash jane te pagueshme jashte.

4. Instrumenta bilaterale, te bazuar ne legjislacionin e dy shteteve kontraktuese, ofrojne nje veshtrim qe i pershtatet ne menyre te veçante kerkesave te legjislacionit te vendeve. Megjithate, zakonisht instrumentat bilaterale nuk i zgjidhin veshtiresite e shtetasve te vendeve te tjera qe jane objekt i legjislacionit te dy vendeve kontraktuese; kjo varet nga shtrirja personale.

Me poshte jane dhene shpjegime lidhur me termat e çdo neni te dispozitave model per aq sa keto shpjegime jane konsideruar si te nevojshme.

## **Neni 1**

### Perkufizime

Ky nen permban perkufizimin e koncepteve te perdorura ne kete Marreveshje. Per t'i bere keto koncepte te qarta eshte e nevojshme te perkufizohet çdo gje e papercaktuar ne te njejten menyre ne legjislacionin e te dy vendeve si dhe te jepet sqarim i pershtatshem ne rastet kur fjale te ndryshme perdoren ne legjislacionin e te dy vendeve per te mbuluar nje rast te njejte a paralel dhe/ose perfitim te njejte a paralel.

Neni 1 (a):

Formulimi “ x do te thote dhe .....y do te thote” ne Nenin 1 (a) eshte perdorur per arsye praktike, ne menyre qe te lejoje shkurtimin e emrave te Paleve Kontraktuese. Shembull: Austri do te thote Republika e Austrise, ose U.K. do te Mbreteria e Bashkuar e Britanise se Madhe dhe Irlandes se Veriut.

## **Neni 2**

### Shtrirja materiale

1. Shumica e instrumentave te nenshkruar ndermjet vendeve te Evropes Perendimore mbulojne te gjitha rastet e parashikuara ne legjislacionin e sigurimeve shoqerore. Prandaj ato quhen shpesh “konventat e pergjithshme te sigurimeve shoqerore”. Disa, megjithate, kufizohen ne nje numer te kufizuar rastesh.

2. Per me teper, instrumenta te tille normalisht mbulojne skema te pergjithshme te cilat zbatohen pa dallim per te gjitha te interesuarit, per shembull, personat e punesuar, popullsia aktive ose rezidentet. Ato mund te shtrihen, bashkerisht ose

veçan, ne skema te veçanta qe zbatohen vetem ne nje kategori pune specifike, (minatore, peshkatore, punonjes te vete-punesuar).

3. Me ne fund, sipas rrethanave, instrumenta bilaterale mund te zbatohen si per skemat kontribuese dhe jo-kontribuese (d.m.th. skema qe japin perfitime, dhena e te cilave nuk varet nga nje kontribut i drejperdrejte nga personat e mbrojtur ose nga punedhësi i tyre).

4. Shtrirja materiale aktuale e nje marreveshjeje mund te pershkruhet ose duke kuotuar bazen ligjore apo skemat kombetare (p.sh. “ligji federal mbi sigurimin ne rast semundjeje” ose “sigurimi ne rast semundjeje” – Alternativa 1) ose duke iu referuar drejperdrejt perfitimeve te ndryshme ( duke ndjekur trajtimin e Alternatives 2 te Nenit 2 te Konventes Evropiane mbi Sigurimet Shoqerore).

### **Neni 3**

#### Shtrirja personale

Ne pergjithesi, instrumentat bilaterale zbatohen per te gjithë shtetasit e Vendeve Kontraktuese, per sa kohe ato mbuloohen nga legjislacioni mbi çështjet e mbuluara nga keto instrumenta. Si rezultat, instrumentat mund te mbulojne te gjitha kategorite e punonjesve (te punesuar, te vete-punesuar, kufitare, sezonale, e keshtu me radhe) ose te gjithë rezidentet, duke perfshire ata qe nuk kane pune ne rastin e nje kufizimi tek vendasit ne pergjithesi. Ato zbatohen gjithashtu edhe per pjesetaret e familjeve te vendasve te vendeve Kontraktuese dhe trashegimtarete e tyre, pavaresisht nga kombesia e tyre, kur te drejtat e tyre rrjedhin nga te drejta te fituara nga ata vendas. Disa nga keto instrumenta bilaterale bazohen nje nje shtrirje me te gjere personale e cila shtrihet tek te gjithë personat e siguruar, pavaresisht nga kombesia e tyre, persona pa shtet dhe refugjate, pjesetare te familjeve te tyre dhe trashegimtarete e tyre qe banojne ne territorin e njerit prej vendeve Kontraktuese.

### **Neni 4**

#### Trajtimi i barabarte

1. Legjislacioni kombetar dhe praktika, shpesh e kufizojne barazine e trajtimit ndermjet vendasve dhe jo-vendasve, veçanerisht ne lidhje me te drejtat per perfitime. Kategorite e perfitimit te trajtuara me shpesh perfshijne te gjitha llojet e perfitimeve sipas skemave kalimtare, perfitimin e papunesise dhe ndihmat familjare. Per me teper, situata te tilla si qendrimi jashte shtetit, shpesh çojne ne dispozita ligjore kufizuese, veçanerisht ne lidhje me perfitimin e invaliditetit, te pleqerise ose te trashegimtareve, si dhe perfitime ne lidhje me demtime a semundje profesionale. Prandaj, instrumenta te ndryshem koordinimi shtrojne parimin e trajtimit te barabarte. Instrumentat bilaterale ekzistues ne pergjithesi e parashikojne zbatimin e ketij parimi themelor nepermjet te cilit vendasit e njerit

shtet kontraktues jane objekt i detyrimeve dhe te drejtave per perfitime te legjislacionit te shtetit tjeter kontraktues ne te njejtat kushte si vendasit e ketij te fundit.

2. Megjithate, instrumentat bilaterale nuk japin barazi trajtimi te pergjithshme dhe te pakushtezuar ne çdo rast. Ato ne pergjithesi bazohen ne parimin e reciprocitetit, duke e bere nje kusht kombesine e njerit prej shteteve kontraktuese, edhe pse nje numer instrumentash ne rritje parashikojne gjithashtu barazi trajtimi per te gjithë personat qe jane ose kane qene objekt i legjislacionit te shteteve kontraktuese. Per me teper, ne varesi nga natyra e tyre dhe trajtimi i pergjithshem, sistemet kombetare mund te perfshijne kushte qe kane te bejne me periudhen e qendrimit te kerkuar per dhenien e disa perfitimeve ose vendin ku ato mund te jepen. Keshtu, barazia e trajtimit ne lidhje me perfitimet jo-kontribuese shpesh eshte objekt i plotesimit te nje fare periudhe qendrimi. Kjo kerkese eshte veçanerisht e kuptueshme ne rastin e perfitimeve afat-gjata te dhena pa ndonje kusht tjeter kualifikimi.

## Neni 5

### Eksportimi i perfitimeve

Ky nen parashikon, me perjashtimin e parashikuar ne paragrafin 2, eksportimin e perfitimeve; kjo eshte e nevojshme per te mos pranuar legjilacionin kombetar qe normalisht e kufizon pagesen e perfitimeve ndaj pesonave qe banojne ne territorin e vendit

Me marreveshje reciproke, Marreveshja bilaterale mund te parashikojë gjithashtu qe ne rast se perfituesi banon ne nje shtet te trete, perfitimi te paguhet ne kete Shtet.

## Nenet 7 dhe 8

### Legjislacioni i zbatueshem

1. Rregullat qe drejtojne legjislacionin e zbatueshem jane percaktuar ne menyre qe emigrantet te mos bien ne njerën nga situatat e meposhtme: jo mbrojtje ne asnje vend ose mbrojtje e njekohshme ne dy vende. Ndonjehere mbrojtja u jepet atyre qe banojne ne vendin e interesuar, ndonjehere atyre qe punojne ne ate vend. Ne mungese te koordinimit, zbatimi i kriterëve te ndryshme per anetaresimin ne skemat kombetare te sigurimeve shoqerore mund te çojë ne konflikte ligji. Per shembull, nje konflikt negativ ligji mund te linde kur personi i interesuar nuk eshte i mbrojtur ne asnje nga vendet. Ne kushte te tjera, konflikti mund te jete pozitiv, kur personi i interesuar eshte i mbrojtur njekohesisht ne te dy vendet. Keto anomali, qe paraqesin nje kercenim potencial per interesat e emigranteve, duhet te eliminohen nepermjet rregullave te koordinimit qe plotesojne rregullat kombetare qe drejtojne legjislacionin pergjegjes.

2. Teoria dhe praktika kombetare kane pranuar parimin se vetem legjislacioni i nje vendi eshte i zbatueshem. Duke perjashtuar rastin e sigurimit vullnetar, zbatimi veçan i njerës a tjetres dege te nje sistemi kombetar nuk njihet normalisht, te pakten ne instrumentat e nenshkruar nga vende me sisteme te zhvilluara te sigurimeve shoqerore. Nje dallim i tille ndermjet degeve mund te hyje ne konflikt me natyren unitare te shumices se sistemeve dhe te krijoje nderlikime administrative duke tejkualuar disa avantazhe qe duhet te ofronte. Per me teper, nuk eshte praktika te lejohen kerkuesit te vendosin se cili sistem do te zbatohet per ta, sepse ata ne menyre te paevitueshme do te zgjidhnin ate qe ofron avantazhet me te medha. Megjithate, duhet verejtur se disa instrumenta bilaterale lejojne zbatimin e njekohshem te legjislacionit te te dy Paleve Kontraktuese, ne rastet ku individi i interesuar eshte i punesuar ne dy aktivitete pune te ndryshme, por konkruese ne te dy vendet.

3. Nje shqyrtim i instrumentave bilaterale tregon se kriteret per te percaktuar legjislacionin e zbatueshem jane te shumellojshem dhe komplekse. Zgjedhja nuk lind ne rastin e personave qe nuk punojne sepse kriteri i vetem qe zbatohet per ta eshte vendi i banimit. Per rrjedhoje, situata ndryshon sipas menyres se si konsiderohen emigrantet e punesuar ose kategori te tjera punonjesish. Karakteristikat kryesore te legjislacionit perkates te vendeve, ne terma te personave te mbuluar, jane gjithashtu nje faktor.

4. Ne rastin e personave te punesuar, kriteri i zakonshem eshte vendi i punes, cilido qofte vendi i tyre i banimit apo vendi ku ndermarrja per te cilen punojne ka seline e saj. Sipas ketij kriteri, punetoret emigrante jane objekt i legjislacionit te vendit te emigrimit, ndersa punetoret kufitare dhe sezonale jane gjithashtu objekt i legjislacionit te vendit ku ata kryejne punen e tyre te rregullt ose sezonale, edhe pse vazhdojne te banojne ne vendin e tyre te origjines. Legjislacioni i zbatuar per personat e vetepunesuar mund te bazohet gjithashtu ne vendin ku ata kryejne aktivitetin e tyre ose ne vendin e tyre te banimit.

5. Rregulla te veçanta kerkohen per kategorite e punetoreve emigrante per te cilet nuk mund te zbatohen rregullat e pergjithshme. Keto rregulla ndryshojne nga vendi ne vend sipas natyres dhe kushteve te punes te kategorive te interesuara. Shembuj te rasteve te tilla te veçanta perfshijne punonjesit e derguar ne nje vend te huaj, qe shpesh ruajne te drejten te mbeten objekt i legjislacionit te vendit te tyre te origjines per nje fare periudhe me qellim qe te merret parasysh natyra e perkohshme e punes se tyre, punonjesit shetites, te tille si punonjesit e transportit nderkombetar ose disa perfaqesues nderkombetare qe, zakonisht punojne ne territorin e dy a me shume vendeve, dhe marinaret. Kriteri i zbatuar per punonjesit shetites bazohet ne pergjithesi ne vendin ku ndermarrja ka seline e saj, ose ne mungese, vendin e banimit te personave te interesuar, ndersa per marinaret eshte ose vendi nen flamurin e te cilit lundron anija e tyre, ose vendi i regjistrimit te saj.

6. Ne nenin 7, dispozitat qe kane te bejne me legjislacionin e zbatueshem japin nje zgjidhje vetem lidhur me personat aktive. Megjithate, po njihet se ne disa vende sistemet e sigurimeve shoqerore bazohen ne vendin e banimit. Prandaj per keto vende duhet te ishte zgjedhur nje zgjidhje e ndryshme.

7. Persa i perket Nenit 8, paragrafi 1, mund te shtohet ndonje dispozite tjeter per pjesetaret e familjes qe shoqerojne, por atehere do duhej hartuar nje zgjidhje ne lidhje me ata pjesetare familjeje qe zene nje pune ne vendin e vendosjes se kryefamiljarit.

## Neni 9

### Personeli i ndermarrjeve te transportit nderkombetar

Neni 9 ka te beje me mbulimin e punonjesve ne industrite e transportit nderkombetar. Ai parashikon qe nje punonjes i tille eshte:

1. zakonisht banues ne njerin vend dhe eshte plotesisht ose kryesisht i punesuar atje, ai eshte i mbuluar nga legjislacioni i atij vendi; ne te kundert
2. nese ai eshte i punesuar nga nje dege ose agjensi e biznesit te punedhenesit te tij qe ndodhet ne njerin vend, ai eshte i mbuluar nga legjilacioni i atij vendi, ne mungese te te cilit
3. ai eshte i siguruar nen legjislacionin e vendit ne te cilin punedhenesi i tij ka seline e tij.

Neni e ve theksin ne vendin e banimit te punonjesit si percaktuesi perfundimtar per pergjegjesine e kontributeve. Ne shume vende, pergjegjesia per kontributet i mbetet punedhenesit. Prandaj, logjika mund te diktonte qe selia duhet te percaktoje se ku duhet shtrire pergjegjesia per kontributet, pervec vendit te banimit te punonjesit. Por zbatimi i nje dispozite te tille mund te bente qe nje person te sigurohej sipas legjislacionit te nje vendi ku ai s'ka jetuar kurre. Kjo nuk eshte e arsyeshme. Megjithate, ne nje perpjekje per te adresuar problemin e marrjes se kontributeve nga nje punedhenes ne nje vend tjeter nga ai ku banon punonjesi dhe, per pasoje, ku pergjegjesia u takon rregullimeve administrative, permban nje dispozite bashkepunimi.

## Neni 11

### Misionet diplomatike dhe postet konsullore



Neni 12 percakton legjislacionin e zbatueshem persa i perket personave qe punojne ne misione diplomatike ose poste konsullore. Si rregull anetaret e misioneve diplomatike ose posteve konsullore jane objekt i legjislacionit te sigurimeve te Shtetit dergues. Kjo eshte gjithashtu ne perputhje me rregulloret e parashikuara nga Konventa e Vjenes mbi Marredheniet Diplomatike.

Personat e punesuar ne vend jane ne parim objekt i legjislacionit te Shtetit prites. Personat qe jane qytetare te Shtetit dergues, megjithate, mund te zgjedhin per t'u mbuluar nga legjislacioni i atij Shteti. Ne menyre qe te shmangen nderlikimet administrative, kjo e drejte zgjedhjeje mund te ushtrohet nje here, brenda tre muajsh nga data ne te cilen personi ne fjale eshte angazhuar nga misioni ose posti, ose ne sherbimin privat te nje zyrtari te misionit ose postit, sipas rastit.

### **Neni 13**

#### Grumbullimi i periudhave te sigurimit

Ky nen parashikon grumbullimin e periudhave te sigurimit sipas parimit te ruajtjes se te drejtave.

Paragrafi 2 eshte nje shtojce e mundshme e paragrafit 1 per te shmangur mbivendosjen e papershtatshme te perfitimeve kur e drejta per te perfituar ne nje vend nuk varet ne sigurimin aktual, por ne nje sigurim ne nje periudhe te dhene ne te shkuaren.

### **Neni 15**

#### Rezidenca ne Shtetin tjetër

Personat te cilet banojne ne territorin e nje vendi tjetër nga ai i Shtetit kompetent do te kene te drejte te perfitojne ne natyre gje qe do te jepet nga institucioni i vendbanimit ne perputhje me legjislacionin e zbatuar nga ky institucion, me shpenzimet e institucionit kompetent.

Ky rregullim u vendos sepse eshte normale qe perfitimet ne natyre te jepen nga institucioni me i afert me perfituesin, i cili mund ta kontaktoje ate direkt dhe te kryeje ekzaminimet e nevojshme mjekesore dhe administrative.

Paragrafi 4: ne menyre te ngjashme, nen kete paragraf pjesetaret e familjes do te kene te drejte te perfitojne ne natyre ne vendin ne te cilin banojne.

## Neni 17

### Pensionistet dhe pjesetaret e familjes se tyre

Ndersa formulimi i alternativës 2 korrespondon me formulimin e Neneve 14 dhe 15 (“do të marrë përfitime në natyrë”), në alternativën 1 fjalet “do të jetë objekt i legjislacionit” janë përdorur (në përputhje me pjesën II). Kështu, një pensionist që merr një pension vetëm nga një vend do të trajtohet në vendin tjetër (d.m.th. në vendin e banimit) sikur të ishte shtetas i këtij vendi. Për rrjedhojë, nuk kerkohen dispozita shtese për pjesetaret e familjes dhe Nenet 14 dhe 15 janë të zbatueshme pa iu bërë ndonjë referencë tjetër.

Paragrafi i tretë i këtij Neni parashikon dënimin e përfitimeve në natyrë për pensionistet dhe pjesetaret e familjes së tyre nga institucioni i vendit të tyre të banimit

Gjate një qëndrimi në Palen tjetër Kontraktuese dispozitat e Nenit 15 janë të zbatueshme.

## Neni 19

### Rimbursimet

Kjo dispozitë u formulua në alternativën 1 me kuptimin më të gjërë që është e mundur, por me shumë zgjidhje kufizuese mund të përdoren gjithashtu, të tilla si alternativa 2.

Përfitimet e parashikuara nga kjo Pjesë e Marrëveshjes nga institucioni i njërës Palë Kontraktuese me shpenzimet e institucionit kompetent të Palës tjetër Kontraktuese do të kompensohen në përputhje me shpenzimin ekzistues.

## Neni 20

### Përfitimet e invaliditetit, pleqerisë dhe të trashëgimtareve (Grumbullimi i periudhave të sigurimit)

Në përputhje me parimin e ruajtjes së të drejtave në fitim e sipër, emigrantet mendohet të kenë një regjistrim të unifikuar të periudhave të sigurimit, edhe pse ata kanë qenë objekt i legjislacionit të të dy vendeve. Një legjislacion i tillë e bën fitimin dhe shtrirjen e të drejtës objekt të një periudhe kualifikimi. Kohezgjatja e kësaj periudhe ndryshon në përputhje me rastin.

Ky nen ka të bëjë me probleme të ndryshme që trajtojnë fitimin e të drejtave – dhe në disa raste shtrirjen e këtyre të drejtave – nga persona që kanë qenë në mënyrë të njëpasnjëshme në legjislacionin e dy vendeve, periudhat e plotësuar në sistemet e këtyre vendeve duhet të trajtohen sikur të kishin qenë plotësuar në një dhe të njëjtin

sistem. Procedura eshte hartuar per te percaktuar nese kushtet qe kane te bejne me kohezgjatjen e sigurimit, punesimit, aktivitetit te punes ose vendbanimit te parashikuara ne legjislacionin e nje vendi per fitimin e te drejtave ose shtrirjen e te drejtes jane plotesuar duke marre parasysh, per sa eshte e nevojshme, periudhat e sigurimit, punesimit, aktivitetit te punes ose vendbanimit te plotesuara ne vende te tjera. Kjo teknike eshte permendur si grumbullimi ose mbledhja bashke e periudhave. Keshtu behet e mundur te mblidhen bashke periudha te nje natyre te ndryshme te plotesuara ne dy vende, duke pasur parasysh se si jane percaktuar keto periudha, gje e cila varet shpesh nga legjislacioni perkates dhe rregullat e konvertimit te cilat jane vendosur me marreveshje te perbashket ne instrumentat e zbatueshem.

## Neni 21

### Dhenia e perfitimeve

Grumbullimi i periudhave me qellim llogaritjen e perfitimit bazohet ne parimin se shuma e nje perfitimi, veçanerisht nje pension, i pagueshem sipas skemave kontribuese dhe jo-kontribuese, mund te varet nga kohezgjatja e periudhave te plotesuara. Shumica e instrumentave percaktojne nje trajtim koordinimi te pranuar ne pergjithesi (metoda e quajtur “proporcionale”), sipas te cilit institucioni kompetent i secilit shtet kontraktues te interesuar percakton shumen teorike te pensionit i cili do t'i paguhej personit te interesuar sipas legjislacionit qe zbaton, nese te gjitha periudhat e marra parasysh sipas parimit te grumbullimit te jene plotesuar nen kete legjislacion dhe pastaj llogarit shumen e pagueshme aktualisht nga vetja mbi bazen e periudhave te plotesuara nen kete legjislacion si nje proporcion i periudhave totale te plotesuara nen legjislacionin e vendeve te ndryshme objekt i te cilave ka qene personi i interesuar. Megjithate, kur legjislacioni i nje shteti kontraktues percakton se shuma e nje pensioni eshte ne proporcion me kohezgjatjen e periudhave te plotesuara, institucioni kompetent i shtetit mund ta llogarise pensionin ne menyre te drejtperdrejte. Per me teper, nese shuma qe mund te kerkoje personi i interesuar sipas legjislacionit te nje shteti kontraktues, eshte me e madhe se shuma e elementeve te pensionit te llogaritur mbi baze proporcionale, nje shtese e barabarte me diferencen duhet te paguhet nga institucioni kompetent qe zbaton kete legjislacion. Megjithate duhet verejtur se disa instrumenta bilaterale nuk e perdorin gjithmone kete sistem. Ne mungese te kesaj mbrojtjeje, ato i lejojne personat e interesuar te zgjedhin pagesen e veçante te pensioneve te pagueshme nen legjislacionin e vendeve te ndryshme, objekt i te cileve kane qene ata, ne vend te pageses se bashkuar. Por ne ndonje rast tjeter kjo eshte gjithmone e lejuar.

Te dy alternativat per llogaritjen e perfitimeve e marrin parasysh kete. Ndersa ne te dy alternativat e drejta kombetare garantohet nese zbatimi i Nenit 20 nuk eshte i nevojshem per te drejten per perfitime, te dy alternativat japin zgjidhje te ndryshme per rastet e tjera; alternativa 1 parashikon llogaritjen “proporcionale” ndersa alternativa 2 mundeson nje llogaritje te drejtperdrejte pa nevojen per te njohur shumen ekzakte te periudhave te sigurimit te vendit tjeter.

Shembuj:

### **Pensioni i pleqerise**

Llogaritja kombetare e periudhes kualifikuese

Shteti A: 10 vjet 15 vjet 30% e shumes baze

Shteti B: 20 vjet 1% per çdo vit

Alternativa 1:

A: Shuma teorike  $30\% + (20 + 10) \times 1\% = 60\%$   
Perfitimi I pagueshem  $60\% \times 10/30 = \underline{20\%}$

B:  $30\% + (20 \times 1\%) = \underline{50\%}$  (proporcioni:  $60\% \times 20/30 = 40\%$ )

Alternativa 2:

A:  $(30\% \times 10/30) + (10 \times 1\%) = 10\% + 10\% = \underline{20\%}$

B:  $30\% + (20 \times 1\%) = \underline{50\%}$  (nese nuk ka te drejte kombetare: 40%)

### **Pensioni i invaliditetit**

Aksidenti : mosha 46

Llogaritja kombetare e periudhes kualifikuese

Shteti A: 5 vjet 5 vjet ne fund 1.5% per çdo vit  
10 vjet kalendarike periudhashtese deri ne moshen 60

Shteti B: 10 vjet

Alternativa 1:

A: Grumbullim sipas Konventes

B: Jo grumbullim

A: Shuma teorike:  $[(5 + 10) \times 1.5\%] + (14 \times 1.5\%) = 22.5\% + 21\% = 43.5\%$   
Perfitimi I pagueshem:  $43.5\% \times 5/15 = \underline{14.5\%}$

B:  $(10 \times 1.5\%) + (14 \times 1.5\%) = 15\% + 21\% = \underline{36\%}$  (Proporcioni:  $43.5\% \times 10/15 = 29\%$ )

Alternativa 2:

$$A: (5 \times 1.5\%) + [(14 \times 1.5\%) \times \frac{5}{20}] = 7.5\% + (21\% \times \frac{5}{20}) = 7.5\% + 5.25\% = 12.75\%$$

2/3x30

$$B: (10 + 1.5\%) + (14 \times 1.5\%) = 15\% + 21\% = 36\% \text{ (nes enuk ka te drejte kombetare: 25,5\%)}$$

Modele te tjera llogaritjeje te shumes se perfitimeve te bazuar ne metoden "proporcionale" mund te gjenden ne Raportin shpjegues te Konventes Evropiane te Sigurimeve Shoqerore. (Hollande/Komiteti)

## Neni 22

### Periudhat e sigurimit prej me pak se nje viti

Ky nen ka te beje me pagesen e perfitimeve kur periudha totale e plotesuar nen legjislacionin e nje Pale Kontraktuese eshte me pak se nje vit.

Paragrafi 2 parashikon se, me qellim mbledhjen e periudhave dhe llogaritjen e perfitimit, institucioni i Pales tjeter Kontraktuese do te marre parasysh periudhat prej me pak se nje viti te plotesuara nen legjislacionin e Pales se pare Kontraktuese.

## Nenet 24 dhe 26

### Perfitimet per demtime dhe semundje profesionale

Nese legjislacioni i nje shteti e kushtezon te drejten per perfitime ne lidhje me semundjet profesionale nga ndjekja e nje fare periudhe aktiviteti qe mund te shkaktoje gjendjen ne fjale, institucioni kompetent i atij shteti duhet te marre parasysh, per sa eshte e nevojshme, periudhat kur aktivite te ngjashme jane kryer nen legjislacionin e Pales tjeter Kontraktuese. Ky rregull ka te beje veçanerisht me pneumokoniosis sklerogjenike, por ai mund te shtrihet, me marreveshje ndermjet shteteve te interesuar, ne semundje te tjera profesionale. Ai zakonisht shoqerohet nga dispozita qe lidhen me shperndarjen e kostove te perfitimeve dhe menyren sipas te ciles duhet percaktuar kjo shperndarje.

Neni 26 ka te beje me rastin kur nje punetor qe vuan nga nje semundje profesionale, ka marre ose eshte duke marre perfitime ne lidhje me kete semundje nga institucioni i njeres Pale Kontraktuese dhe kerkon perfitime nga institucioni i Pales tjeter Kontraktuese per shkak te keqesimit te gjendjes se tij. Mbulohen dy situata te mundshme.

Nen-paragrafi (a) mbulon situaten kur nje aktivitet qe mund te shkaktoje ose te keqesoje semundjen nuk eshte kryer ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese; institucioni kompetent qe ka paguar tashme ose eshte duke paguar perfitimin ne lidhje me nje

invaliditet të tilla do të mbulojë koston e perfitimeve të shtuara të pagueshme për keqesimin.

Nen-paragrafi (b) mbulon situatën kur një aktivitet i tillë është kryer nën legjislacionin e Pales tjetër Kontraktuese. Në këtë rast institucioni që ka paguar tashmë ose është duke paguar perfitimet në lidhje me semundjen profesionale, do të vazhdojë të paguajë perfitime të tilla pa marrë parasysh keqesimin; institucioni i Pales Kontraktuese në territorin e së cilës personi i interesuar ka kryer aktivitetin që shkakton keqesimin, do të mbulojë koston e një shtese të barabartë me diferencën ndërmjet shumës që do të ishte e pagueshme, pas keqesimit, sipas legjislacionin që zbaton dhe shumës që do të kishte qene e pagueshme para keqesimit, nëse semundja do të ishte marrë në territorin e tij.

### **Neni 27**

#### Perfitimet e papunesisë

Në shtesë të dispozitës së përgjithshme të mbledhjes bashkë të periudhave të grumbullimit të sigurimit (paragrafi 1), paragrafi 2 i këtij neni parashikon se, nëse sipas një legjislacioni periudha për të cilën paguhen perfitimet e papunesisë ndryshon në përputhje me kohezgjatjen e periudhave të plotësuar, të gjithë rregullat që drejtojnë mbledhjen e periudhave për të drejtën për perfitime do të zbatohen në të njëjtën mënyrë.

### **Neni 28**

#### **Punetoret kufitare**

Ky Nen parashikon se perfitimet që i detyrohen një punetori kufitar që është pjesërisht ose me ndërprerje i papune, do të jenë me shpenzimet e institucionit të Pales Kontraktuese në territorin e së cilës është vendosur ndërmarrja. Këto perfitime do të jepen nga institucioni i Pales Kontraktuese në territorin e së cilës banon perfituesi.

Për punetorin kufitar i cili është teresisht i papune, alternativa 1 parashikon që perfitimet do të jepen nga institucioni në territorin e të cilit banon perfituesi me shpenzimet e këtij institucioni. Sipas alternativës 2 perfitimet do të jenë megjithatë me shpenzimet e institucionit të Pales Kontraktuese në territorin e së cilës është vendosur ndërmarrja ku ka punuar së fundi perfituesi.

### **Neni 30**

#### Dhënia e ndihmave familjare

##### Alternativa 1:

Kjo parashikon se e drejta për ndihma familjare përcaktohet në përputhje me legjislacionin e Pales Kontraktuese në territorin e së cilës është i punësuar personi i

siguruar. Per rrjedhoje, nese femijet e personit te interesuar banojne ne territorin e nje Pale Kontraktuese te ndryshme nga shteti kompetent, ata do te trajtohen sikur te ishin duke banuar ne territorin e atij Shteti. Ne te tilla raste, personi i interesuar mund te marre ndihma familjare sipas legjislacionit te atij Shteti.

*Alternativa 2:*

Kjo dispozite u garanton te gjitha anetareve te familjes ne vendin ne te cilin ata jetojne, ndihma familjare per te cilat kane te drejte nese personi ne fjale, edhe kur eshte punesuar ne nje vend tjetër, ka qene objekt i legjislacionit te vendit te residences te anetareve te familjes.

## **DISPOZITA TE NDRYSHME**

### **Nenet 32 dhe 33**

#### Rregullime per administrimin dhe bashkepunimin dhe perdorimin e gjuheve zyrtare

Keto nene jane mbeshtetur ne dispozitat standarte te Konventes Evropiane per sigurimet shoqerore dhe ne marreveshje dypaleshe per rregullimet administrative dhe bashkepunimin.

Jo te gjitha dispozitat do te jene te nevojshme ne te gjitha marreveshjet.

Paragrafi 5 i Nenet 32 parashikon qe, ne parim, institucioni kompetent i Pales Kontraktuese qe kerkon nje ekzaminim mjekesor ne territorin e Pales tjetër Kontraktuese do te rimbursoje koston e nje ekzaminimi te tille ndaj institucionit kompetent qe e ka rregulluar ate.

Eshte e mundur, megjithate, te parashikohen marreveshje te ndryshme financiare per ekzaminimet e organizuara ne territorin e nje Pale Kontraktuese me kerkese te Pales Kontraktuese tjetër ose te parashikohet qe kostoja e ekzaminimeve mjekesore te kryera ne territorin e nje Pale Kontraktuese me kerkese te Pales tjetër Kontraktuese nuk do te jete objekt i ndonje rimbursimi nga njera Pale Kontraktuese.

### **Neni 35**

#### Paraqitja e nje kerkese ose apelimi

Ky nen i referohet veçanerisht nje kerkese qe ka te beje me perfitimin nje Pale Kontraktuese qe i eshte paraqitur ne menyre te gabuar Pales tjeter Kontraktuese. Kjo s'do te thote se nje kerkese korrekte ne lidhje me nje perfitim te veçante ne nje vend mund te trajtohet si nje kerkese per nje perfitim tjeter te lidhur me te ne vendin tjeter.

### **Neni 38**

#### **Procedurat detyruese**

Ky Nen ka te beje me njohjen dhe detyrimin ne territorin e njeres prej Paleve Kontraktuese, te vendimeve te nje gjykate dhe dokumentat e detyrueshem te Pales tjeter Kontraktuese, persa i perket kontributeve te sigurimeve shoqerore ose kerkesave te tjera.

Per disa vende, perfshirja e ketyre lloj dispozitash ne Marreveshjet dypaleshe mund te ndeshet me disa veshtiresi sipas sistemit te tyre ligjor kombetar.

### **Neni 39**

#### Monedha e pageses

Kur monedha e njeres Pale Kontraktuese s'eshte e konvertueshme, pagesat mund te behen ne monedhen e Pales tjeter Kontraktuese, nese kjo e fundit eshte e konvertueshme, ose ne nje monedhe tjeter te konvertueshme te perdorshme nga te dyja Palet Kontraktuese.

### **Neni 40**

#### Zgjidhja e mosmarreveshjeve

Ky nen eshte detyrimisht mjaft specifik per shkak se, megjithese nuk parashikohet qe marredheniet do te prishen ne nje shkalle te tille sa te sjellin rishikimin e dispozitave, nese marredheniet prishen, disa rregullime te sakta, detyruese mund te rezultonin si shume te dobishme.

### **Neni 41**

#### Dispozita kalimtare

Dispozitat e ketij Neni jane te bazuara ne dispozitat standarte ne instrumentat dypaleshe dhe shumepaleshe. Ne te kundert te instrumenteve shumepaleshe ne veçanti, paragrafi 5 nuk parashikon nje rillogaritje te perfitimeve tashme te percaktuara kryesisht per shkak te arsyeve praktike dhe administrative.

### **Neni 42**



**Ratifikimi**

Ky nen bazohet ne dispozitat standarte ne lidhje me hyrjen ne fuqi te marreveshjeve dypaleshe.

Megjithate, kur kushtetutat e Paleve Kontraktuese parashikojne metoda te ndryshme ratifikimi per hyrjen ne fuqi te marreveshjeve dypaleshe, te tilla si per shembull nje shkembim letrash nepermjet kanaleve diplomatike, nuk do te ndermerret rekurs ndaj metodes se ratifikimit te percaktuar ne kete nen.